



# GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i  
Gjykatës Themelore në Prizren  
Janar – Prill 2016

Buletin informativ “Gjykatë e Hapur”  
Nr. 5, Prill 2016

Botues: Gjykata Themelore në Prizren  
[www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org)

## PËRMBAJTJA:

### FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Gjykata e Prizrenit shembull  
pozitiv për vitin 2015

### STORIE E SUKSESIT

Niveli më i lartë i Gjyqësorit së bashku  
për një bashkëpunim më të mirë

### LAJME

#### GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

#### INTERVISTË E SHKURTË

Intervistë e shkurtë me  
gjyqtarin Xhevdet Elshani

#### GJYKATA NË MEDIA

Zyra me Informim me publikun

#### KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE NË PRIZREN



## Gjykata e Prizrenit shembull pozitiv për vitin 2015

Të nderuar lexues,

Gjykata Themelore e Prizrenit është Gjykatë e hapur e cila përpiqet t'i përfshijë në punën e saj të gjithë qytetarët e Prizrenit. Kjo Gjykatë ka pikë të fortë transparencën.

Si institucion gjyqësor, kemi krijuar një traditë të mirë të bashkëpunimit me shumë partner, të cilën tashmë e kemi zgjeruar me institucionet arsimore, me organizatat aktive të shoqërisë civile e që qëllimi kryesor i yni është transparenca e punës së gjykatës, me qëllim që të rritet besimi i publikut në punën e saj.

E këtë më së miri e dëshmon edhe rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (I/KS), të cilët e kanë monitoruar sistemin gjyqësor të Kosovës në të gjitha nivelet, me qëllim të vlerësimit të performancës së tij, në respektimin e ligjshmërisë, etikës së punës dhe procedurave rregulative, ku në këtë rast Gjykata Themelore e Prizrenit ka arritur me punën e saj dhe transparencën të jetë ndër shembujt më pozitiv nga të gjitha Gjykatat e Kosovës për vitin 2015.

Mision i kësaj Gjykate është pavarësia dhe paanshmëria në ndarjen e drejtësisë. Ky sukses i kësaj gjykate ka arritur falë punës profesionale të gjyqtarëve, të stafit administrativ, të cilët kanë rol kyç në funksionimin e Gjykatës.

Objektivat e mia kryesore si kryetar i gjykatës janë: bërja efikase e gjykatës; zvogëlimi i numrit të lëndëve të vjetërsuara dhe fitimi i besimit të publikut, të cilat në masë të madhe kemi arritur t'i realizojmë.

Andaj, Gjykata Themelore e Prizrenit mbetet e përkushtuar për të jetësuar praktikat e mira që mundësojnë efikasitet, llogaridhënie, paanshmëri dhe transparencë në punën e saj.

**Ymer Hoxha**

**Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren**

---

## STORIE E SUKSESIT

---



### **Niveli më i lartë i Gjyqësorit së bashku për një bashkëpunim më të mirë**

Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren z. Ymer Hoxha, priti në takim Kryetarin e Gjykatës Supreme z. Fejzullah Hasanin, Ushtruesen e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit znj. Tonka Berisha, Kryetarin e Gjykatës Themelore të Prishtinës z. Hamdi Ibrahim, Ushtruesin e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës z. Ali Kutllovci, Kryetaren e Gjykatës Themelore në Pejë znj. El-maze Syka, Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjakovë Vatton Durguti dhe Kryetarin e Gjykatës Themelore në Ferizaj Bashkim Hyseni.

Në këtë takim të nivelit më të lartë të sistemit të drejtësisë janë diskutuar arritjet dhe sfidat me të cilat përballet gjyqësori i Kosovës, ku me theks të veçantë ishte mendimi i përbashkët që edhe më tej duhet dhënë përparësi në vendosjen e lëndëve që lidhen me natyrën korruptive dhe keqpërdorim të autoriteteve dhe pozitës zyrtare.



## Konferenca e parë për media

Gjykata Themelore e Prizrenit me 30 dhjetor 2015 mbajti konferencën me media ku u prezantua raporti i punës vjetore për vitin 2015 të kësaj gjykate. Kryetari Ymer Hoxha gjatë prezantimit të raportit të punës për gjykatën ka njoftuar për zvogëlimin e numrit të lëndëve të bartura, të kryera për vitin 2015.

Tabelat e mëposhtme janë tregues i rezultateve të reformave të cilat janë ndërmarr në gjykatën Themelore të Prizrenit si dhe degët e saj Suharekë dhe Dragash gjatë vitit 2015.



Edhe pse gjykatat vazhdojnë të veprojnë me kapacitete të kufizuara, efikasiteti i gjyqtarëve gjatë vitit 2015 në përqindje ka qenë - Gjykata Themelore e Prizrenit me 79.28 %, Gjykata Themelore në Prizren dega Suharekë me 104.38%, Gjykata Themelore në Prizren dega në Dragash me 94.84% që është dëshmi e përkushtimit të stafit të gjykatës Themelore në Prizren së bashku me degët.

Vlenë të ceket se statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit i rëndon më tepër Divizioni i Kundërvajtjes, ndërsa lëndët me peshë si lëndët që i përkasin Departamentit për Krime të Rënda, Departamentit të Përgjithshëm Penal dhe Civil, ka arritur që numri i këtyre lëndëve të zvogëlohet dukshëm.

Sipas Kryetarit të kësaj gjykate, gjykatat vazhdojnë të kenë nevojë edhe për gjyqtarë shtesë, për bashkëpunëtor profesional, për përkthyes, për rritjen e numrit të stafit administrative, në atë mënyrë që të shtohet niveli i efikasitetit në këtë gjykatë. Gjatë periudhës raportuese gjykata ka bashkëpunuar ngushtë me mediat, OSBE-në, policinë prokurorin me organizatat joqeveritare e në veçanti me OJQ EC Ma Ndryshe.

Gjykata Themelore	Lëndë të trashëguara në fillim të vitit 2015	Lëndë të ardhura deri në muajin nëntor 2015	Gjithsej lëndë në punë deri në muajin nëntor 2015	Lëndë të kryera deri në muajin nëntor 2015	Lëndë të mbetura në fund të muajit nëntor 2015
në Prizren	24,955	43,313	68,268	34,340	33,928
në Suharekë	10,495	2,968	25,776	3,098	14,261
në Dragash	1,293	2,695	3,988	2,556	1,432



## **Gjykata Themelore e Prizrenit priti për vizitë Qendrën Rinore SHL-K me nxënësit e shkollave të mesme të Rahovecit**

Me datën 25 mars 2016 Gjykatën Themelore të Prizrenit e ka vizituar Qendra Rinore ShL-K me nxënësit e shkollave të mesme të Rahovecit. Vizita kishte karakter të praktikës për nxënësit e drejtimit juridik të Shkollës Profesionale të Rahovecit nën përcjelljen e mësimit dhe menaxheres së projektit.

Nxënësit u vendosën në njërin nga sallat e gjyqësorisë ku u pritën nga zëdhënësjja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj, e cila prezantoi strukturën e gjykatës, punën që bënë gjykata, sfidat dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët, mënyrën e komunikimit me qytetarët dhe mjetet e zhvilluara për krijimin e një lidhjeje më të mirë me publikun, ku edhe vazhduan me diskutimet e hapura.

Në pjesën e dytë të takimit, nxënësit patën mundësi të njihen me objektin e gjykatës, me punën që bënë secila zyre me sallat e seancave gjyqësore, dhomën e dëshmitarëve dhe materialet informuese të gjykatës, si dhe iu krijua mundësi të marrin pjesë në ecurinë e një seancë gjyqësore. Gjykata do të vazhdojë traditën e bashkëpunimit me qytetarët me shkollat e qytetit dhe të rajonit.



## Studentët e fakultetit juridik të kolegjit "FAMA" vizitojnë gjykatën

Me datën 25.04.2016, në orën 12:00 , Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan profesorët dhe studentet e Fakultetit Juridik të Kolegjit "Fama".

Vizita kishte për qëllim të nxisë komunikimin më të besueshme mes studenteve dhe Gjykatës Themelore në Prizren dhe tu mundësoj atyre të njihen për së afërmi me gjykatën dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshëm.



Studentët u vendosën në njërin nga sallat e gjykimit ku u pritën nga gjyqtari i Krimeve të Rënda z. Skender Çoçaj, dhe zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj. Prezantimet fillestare u pasuan me diskutim me studentet dhe përfaqësuesve të gjykatës . Ndër të tjera u diskutua për të rejat që ka sjellë reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun.

Në pjesën e dytë të vizitës, studentët vizituan objektin e gjykatës dhe u njohën me shërbimet që i ofron ajo për qytetarët e Prizrenit, me sallat e seancave gjyqësore dhe panë se ku dhe si operojnë departamentet brenda gjykatës.

## Studentët e fakultetit juridik të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" vizitojnë gjykatën

Me datë 20 prill 2016, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

Vizita kishte për qëllim të nxisë komunikimin më të besueshëm ndërmjet studentëve dhe Gjykatës Themelore në Prizren dhe tu mundësoj atyre të njihen për së afërmi me gjykatën dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme.



Studentët u vendosën në njërin nga sallat e gjykimit ku u pritën nga kryetari i Gjykatës z.Ymer Hoxha dhe zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj. Prezantimet fillestare u pasuan me diskutim me studentët dhe përfaqësuesit e gjykatës. Ndër të tjera u diskutua për të rejat që ka sjellë reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për takime direkte me kryetarin e Gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun. Në pjesën e dytë të vizitës, studentët vizituan objektin e gjykatës dhe u njohën me shërbimet që i ofron ajo për qytetarët e Prizrenit, me sallat e seancave gjyqësore dhe panë se ku dhe si operojnë departamentet brenda gjykatës.

# GJYKATA NË NUMRA

## Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela e mëposhtme paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore në Prizren për tre mujorin e parë të vitit 2016, si ato të trashëguara në fillim të vitit 2016, të ardhura, lëndët në proces, lëndët që janë përfunduar në këtë tre mujor dhe ato të mbetura në fund të tre mujorit të parë të vitit 2016. Statistikat e punës për tre mujorin e parë të vitit 2016 janë dëshmia e radhës numerike e përkushtimit maksimal të gjykatës për t'i shërbyer qytetarëve.

Gjykata Themelore Në Prizren	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të TREM-1 2016	Lëndët e ardhura gjatë TREM-1	Gjithsej lëndët në punë gjatë TREM-1	Lëndët e kryera gjatë TREM-1	Lëndët e mbetura në fund të TREM-1	Lëndët e mbetura në fund të TREM-1
Dep.Për Krime Të Rënda	Penale	253	58	311	57	254	98.28
	Paraprake	233	78	311	67	244	85.90
Dep. I Përgjithshëm	Penale	3,208	680	3,888	540	3,348	79.41
	Paraprake	384	68	452	23	429	33.82
	Civile	1,511	352	1,863	432	1,431	122.73
	E. Civile	11,178	689	11,867	1,551	10,316	225.11
	E.P. Me Burg	162	25	187	43	144	172.00
	E.P. Me Gjobë	821	361	1,182	231	951	63.99
	Të Ndryshme	0	3,167	3,167	3,167	0	100.00
	Trashëgimore	31	14	45	33	12	235.71
	Jashtkontestimore	282	112	394	173	221	154.46
Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegjit	232	19	251	49	202	257.89
	Pregaditore	71	25	96	21	75	84.00
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	10,447	8,945	19,392	9,578	9,814	84.00
<b>TOTALI</b>		28,024	14,413	42,437	15,771	26,666	109.42

# INTERVISTË E SHKURTË

## Intervistë e shkurtë me gjyqtarin Xhevdet Elshani



### 1. Si vlerësohet dhe perceptohet roli i gjyqtarit dhe drejtësia?

Perceptimi i qytetarëve për gjyqtarët dhe drejtësinë nuk ka qenë pozitiv, për arsye se dihet që pas luftës ne kemi pranuar një sistem të shkatërruar me numër të madh të lëndëve dhe me një numër të vogël të gjyqtarëve, të cilat lëndë nuk kanë gjetur zgjidhje të shpejt, pastaj ka munguar edhe bashkëpunimi me institucione tjera. Mirëpo ky perceptim negativ për gjykatën ka ndryshuar ngase gjykata ka arritur të reduktoj dukshëm vonesat në zgjidhjen e lëndëve. Lëndët tani më nuk presin në sirtar me vite, por ato zgjidhen brenda një kohë të arsyeshme. Madje Gjykata tani cakton edhe lëndë të vitit 2016. Në brendësi të Gjykatës tani funksionon edhe Zyra për Informim Publik e cila është urë lidhëse ndërmjet Gjykatës dhe qytetarit dhe cila e mban mirë të informuar opinionin publik për punën e Gjykatës. Prandaj, perceptimi i qytetarëve për gjykatën ka ndryshuar në aspektin pozitiv.

### 2. Sa sfiduese është puna e juaj duke pasur parasysh natyrën specifike të profesionit që ushtroni?

Çdo profesion i ka sfidat e veta, vështirësitë, rrezikshmërinë që e përcjell, mirëpo në gjyqësor janë të natyrës më specifike, sepse vendoset për palët me interesa të kundërta. Sfidë tjetër ka qenë edhe numri i madh i lëndëve të pazgjidhura për të cilat qytetarët detyroheshin të presin gjatë që gjykata të caktoj lëndët e tyre. Mirëpo kjo sfidë tani është tejkaluar dhe nuk flasim më për numër të madh të lëndëve por do të flasim vetëm për cilësinë e tyre.

### 3. Sa respektohet parimi i barazisë para ligjit?

Parimi i barazisë para ligjit është një vlerë universale, ajo nënkupton liritë dhe të drejtat e çdo individi. Barazia ndërmjet qenieve njerëzore është pengesë kryesore ndaj diskriminimit për arsye të racës, kombësisë, seksit, fesë dhe gjuhës. Vetëm nëse barazia harmonizohet me lirinë mund të arrihet realisht drejtësia. Përpara ligjit të gjithë janë të barabartë, kjo e drejtë garantohet edhe me Kushtetutën e



Republikës së Kosovës dhe respektohet në të gjitha fazat e procedurës.

#### **4. Gjatë punës suaj të përditshme, cilat lëndë gjyqësore mund ti veçoni si më problematike dhe si i tejkalomi vështirësitë në zgjidhjen e tyre?**

Brenda Gjykatës funksionon edhe Departamenti për Krime të Rënda, i cili merret me lëndët që cekën në nenin 15 të Ligjit për gjykata dhe në nenin 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, pra me lëndët, vepra penale e së cilës është e dënueshme mbi 10 vjet burgim efektiv.

Pasi që ushtroj funksionin e gjyqtarit për krime të rënda vlen të cekët se natyra e këtyre lëndëve është e rëndë dhe kërkohet një angazhim i madh që këto lëndë të kësaj natyre të kryhen me sukses. Për shkak të specifikave të veta që bartin këto lëndë nuk mund të përfundojnë me një kohë të shkurtër, problematike janë ekspertizat gjyqësore të cilat jo rrallë duhet të bëhen

jashtë shtetit në laboratorë specifik. Po ashtu në dispozitat e procedurës penale ndonjëherë edhe hasët në dispozitat kundërthënëse, nuk përputhen dispozitat e etapave të ndryshme gjyqësore dhe nuk janë në harmoni në mes vete e që më duket që është rezultat i grupeve komisioneve nga legjislacionet e veçanta jashtë Kosovës që kanë inkorporuar në Kodin e Procedurës Penale. Gjatë karrierës sime si gjyqtar kam shqiptuar dënime të rënda deri në 30 vjet burgim efektiv për vepër penale vrasje e trefishtë. Prandaj për të shqiptuar këto dënime nuk është punë e lehtë, kërkon përgatitje dhe angazhim maksimal.

#### **5. Sipas jush si mund të avancohet në të ardhmen besimi i qytetarëve në punën e gjyqësorit?**

Mendoj se besimi i qytetarëve në punën e gjyqësorit arrihet me punën profesionale të gjyqtarëve me rritjen e efikasitetit të gjykatave në uljen e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor.

---

## **GJYKATA NË MEDIA**

---

### **Zyra për Informim me publikun**

Në bazë të raportit të BIRN-it, Gjykata ka reflektuar në mënyrë pozitive duke qenë bashkëpunuese dhe ka një nivel të mirë të transparencës, duke bërë publike njoftimet për orarin e seancave gjyqësore, publikimin e raporteve tremujore dhe vjetore, procesverbalet dhe dosjet e lëndëve të cilat sipas ligjit janë të hapura për publik. Gjithashtu Zyra për Informim është mjaft ekspeditive edhe në njoftimin për caktimin e masave të paraburgimit dhe shqiptimin e dënimeve në raste gjyqësore.



# KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE NË PRIZREN

## ZYRA E ADMINISTRATËS:

Tel: +381 (0) 29 / 244 122

## ADRESA:

Gjykata Themelore e Prizrenit  
Rr. "Ibrahim Lutfiu ", p.n.  
Prizren, Kosovë

## VIZITO:

[www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org)



**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU –PRIZREN TEMEL MAHKEMESI  
BASIC COURT OF PRIZREN



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
**EC MA NDRYSHE**

*Ky dokument është rezultat i bashkëpunimit mes Gjykatës Themelore në Prizren dhe EC Ma Ndryshe, në kuadër të iniciativës "Gjykatë e Hapur".*